



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTRI

Nr. 7076 / Prot  
1

Tiranë, më 18.10.2021

**URDHËR**

Nr 516, datë 18.10.2021

**PËR**

**PEZULLIMIN E PROCEDURËS SË KONKURRIMIT PUBLIK PËR DHËNIEN  
ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE NË PRONËSI TË SHETITIT QARKU VLORË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, Kreu VII “Dhe vendimet e ndërmjetme”, neni 66 “Çështjet paraprake”, Ligjit nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënie me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar, Vendimit nr. 373, datë 20.6.2018, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave procedurave dhe kontratës TIP për dhënie me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar;

**URDHËROJ:**

1. Pezullimin e procedurës së konkurrimit publik për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me sipërfaqe 6.4 ha, pasuria nr. 445, Zona Kadastrale 3382, e cila ndodhet në fshatin Shkallë, Bashkia Konispol, qarku Vlorë, me datë zhvillimi 19.10.2021, ora 11.00.
2. Ky pezullim u vendos në zbatim të Ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, Kreu VII “Dhe vendimet e ndërmjetme”, neni 66 “Çështjet paraprake”, në të cilin parashikohet se “Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballat me një çështje, zgjidhja e së cilës

është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë”.

3. Njoftimi për pezullim do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, në ambjentet e Bashkisë Konispol, Agjencisë Rajonale të Ekstencionit Bujqësor Lushnjë, në faqen zyrtare të MBZHR-së dhe një gazetë kombëtare.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë,

